



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

---



## **PROCESVERBAL**

**I pranimiit teknik te perkohshem te punëve ne projektin “Ndertimi i  
kanalizimit ne Kpuz ” Komuna e Klinës**

**Klinë: 09.08.2019**

I përpiluar me datën,09.08.2019 nga ana e komisionit për pranim teknik të punëve në projektin **“Ndertimi i kanalizimit në kpuz” Komuna e Klinës**  
Komisioni është formuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me Vendim 06 nr351- 32472/19 të datës 06.08.2019 me këtë përbërje

1. Visar Bojaj
2. antonie Selmanaj
3. Dardan Bashota

Komisioni me përbërje të plotë ka filluar me punë me 09.08.2019 në ora 11, ku të pranishëm ishin menaxheri i kontratës si dhe përfaqësuesi i punëkryesit.

Detyrë e komisionit për kontrole teknik është shqyrtimi i dokumentacionit investivo teknik në bazë të së cilit është ndërtuar objekti dhe shikimi i punëve të kryera në vend.

Në bazë të shikimit të dokumentacionit investivo teknik komisioni ka konstatuar :

### **I Të dhënat e përgjithshme**

- investitor Komuna e Klines
- punëkryes OE“ ALTICOM” me seli në Kline,
- kontrata në mes të Komunës së Klinës dhe OE “ALTICOM” nga Klina nr.11/2019 me numër protokoli 01nr.352-13661/19 e datës 05.04.2019 me vlerë 86.068.22€
- Vendimi për menaxhimin e kontratës 01nr.352-13661/19 të datës 05.04.2019
- Vendimi i komisionit për pranim teknik 06nr.351-32472/2019 të datës 06.08.2019
- Planin dinamik 55 ditë pune.

### **II Kontrolli i dokumentacionit teknik**

- Projekti me paramasë dhe parallogari
- Paramasa e punëve të realizuara
- Ditarin ndërtimor
- Libri ndërtimor
- Fotografitë e realizuara gjatë punimeve

### **III Kontrolli i punëve të kryera në vend**

Pas shikimit të dokumentacionit investivo -teknik ,anëtarët e komisionit në praninë e përfaqësuesit të ekzekutimit të punimeve, menaxherit të projektit dhe organit mbikëqyrës bënë shikimin në vend me qëllim të kontrollit të kualitetit të punëve të kryera,veçanërisht në aspektin e plotësimit të kërkesave themelore për ndërtim dhe me këtë rast konstatoi:

- Ndertimi i kanalizimit në Kpuz komuna e Klines është ndërtuar sipas kontratës dhe parakushteve të ofruara nga projekti.

Andaj pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko investiv që pati në dispozicion komisioni, dhe pas shikimit të punëve në vend, bazuar në konstatimet e lartcekura jep këtë :

## **PERFUNDIM**

Ndertimi i kanalizimit ne Kpuz Komuna e Klines është ndërtuar ne pajtim me dokumentacionin teknik dhe projektin . Gjatë ndërtimit janë aplikuar normativat dhe standardet e kërkuara për këtë lloji ndërtimi. Andaj behet pranimi teknik i perkohshem deri ne kalimin e afatit garantues ku do te behet dhe pranimi perfundimtar. Komisioni përfundoj me punë ne ora 15,00h.


**Menaxheri i projektit**

**Lorenc Marleku** 

**Menaxheri i kontrates**

**Luan Qerkinaj** 

**Komisioni për pranim teknik:**

**1. Visar Bojaj** 

**2. Antonie Selmanaj** 

**3. Dardan Bashota** 